



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.77/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevc i anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatëve në hapësira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 700.00 (shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datën 25.09.2017, në rrugën "Arbëri", tek rreth-rrotullimi mes Rr. "Tirana" dhe Rr. "Bekim Fehmiu në Prishtinë, në murin publik dhe rrugë publike janë vendosur disa poster të kandidatit për anëtarëtë Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që janë vendosur poster në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 27.09.2017, subjekti politik PDK, konsideron se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore. Përkundër kësaj dega e partisë në Prishtinë ka ndërmarr masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur një fotografi në të cilën shihet se janë larguar posterët nga vendi ku kanë qenë të vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet se poster të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjektit politik PDK, janë vendosur në hapësira publike përkatësisht në murin publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapësira apo në rrugë publike”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që poster të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga ky subjekt, janë vendosur në hapësira publike përkatësisht në murin publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti postertë kandidatëve për Kuvend Komunal të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterët nga vendi i palejuar ku kanë qenë të vendosur, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.77/2017 me datën 28.09.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.